



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2445, datë 10.04.2014

Për

*Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 2417, datë 04.02.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)”*

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 10.04.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

*Shqyrtimi i ankimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 2417, datë 04.02.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);

2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
4. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, datë 31.07.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP (*Rregullorja*);

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 982/2Prot., datë 10.3.2014 (nr. 577Prot. i AKEP, datë 10.3.2014) me anë të së cilës ka paraqitur ankim administrativ për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2417, datë 04.02.2014, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)*”.
2. Vendim Nr. 2341 date 31.07.2013, Për “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: “Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të përbashkët-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) – Dokumenti Këshillim Publik*”;
3. Vendim Nr. 2416 date 04.02.2014, Për “*Miratimin e Dokumentit: “Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të përbashkët-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Perfundimtar*”;
4. Vendim nr. 2417, datë 04.02.2014 për “*“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)*”.
5. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);  
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

Albtelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 982/2Prot., datë 10.3.2014, ka paraqitur ankim administrativ për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2417, datë 04.02.2014, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)*”.

Albtelecom me këtë ankim konfirmon edhe njëherë qëndrimin e paraqitur në komentet e bëra gjatë këshillimit publik.

Argumentet ligjore, rregullatore dhe ekonomike ku Albtelecom mbështet ankimin e tij administrativ janë si vijon:

1. Albtelecom shprehet se vlerësimet e AKEP në përfundim të analizës përkatëse janë të atilla që tregu me pakicë i aksesit në internet rezulton të jetë konkurrues. Paketat e operatorëve alternativë të licensuar për të ofruar shërbime të aksesit broadband në internet në nivel pakice janë mjaft kompetitive dhe kjo ka ndikuar në sjelljen e konsumatorëve duke bërë që Albtelecom të humbasë pjesë të tregut dhe tendencat janë të tilla që dëshmojnë për vazhdimësinë e turrjes të pjesëve përkatëse të Albtelecom. Ky treg rezulton të jetë konkurrues pavarësisht masave rregullatore në tregjet përkatëse të shumicës. Në referencë edhe të Rek. 2007/879/EC, ndër të tjera parashikon që “Objektivi i cdo ndërhyrje rregullatore ex-ante është vetëm për të prodhuar përfitime për përdoruesit fundorë duke e bërë tregun me pakicë konkurrues në baza të qëndrueshme”. Detyrimet në tregjet përkatëse të shumicës imponohen kur nga analizat përkatëse gjendet mbyllja e tregjeve dhe vërehet se mundësitë e zgjedhjes apo të zëvendësueshmërisë së shërbimeve për përdoruesit fundorë janë të limituara dhe të ndikuara nga operatorë me pozita monopoliste. Ndërkohë që sikur se citon dhe AKEP, konkurrenca në tregjet e pakicës është gjithnjë e në rritje jashtë ndikimit të efekteve rregullatore të imponuara Albtelecom-it. Masat rregullatore në nivel shumice me arsyetimin për të rritur konkurrencën dhe përfitimet që ajo passjell për përdoruesit fundorë nuk i shërbejnë më qëllimit për të cilin janë vendosur.
2. Albtelecom shpjegon se, konkurrenca në tregun e pakicës nuk është rrjedhojë e masave rregullatore, por rezultat i faktorëve të tjerë si ndërtimi i infrastrukturave paralele nga operatorët në pjesë të territorit ku ato operojnë, zhvillimi i teknologjive të reja si ajo 3G apo rrjetet WI- FI, kartat MODEM USB, të cilat kanë zbehur ndjeshëm fuqinë e pretenduar të Albtelecom. Investimet e shumta të Albtelecom në teknologji dhe në infrastrukturën e rrjetit të aksesit, kalimi në NGN me qëllim rritjen e cilësisë dhe të gamës së shërbimeve në të dy nivelet e tregjeve për të qenë sa më pranë kërkesave të përdoruesve, duket se nuk kanë zgjuar interes për operatorët e tjerë. Konkurrenca gjithnjë e në rritje në tregun e pakicës nuk është pasojë e ndërhyrjeve rregullatore në nivel shumice. Pra, lidhja e drejtpërdrejtë shkak-pasojë mes ndërhyrjeve rregullatore në nivel shumice për të rritur konkurrencën në nivel pakice duket se nuk ekziston, tregu është zhvilluar jashtë efekteve të rregullimit.
3. Albtelecom shprehet se, dokumenti përfundimtar analizon parimin e monopolistit hipotetik sipas të cilit një produkt konsiderohet të përbëjë një treg më vehte nëse “monopolisti” që ofron produktin mund të rrisë cmimin e këtij produkti për një periudhë kohe jo tranzitore dhe të mos ketë rënie në shitje deri në nivelin që kjo të jetë jo-fitimprurëse (fq.15). Kjo nuk mund të përbëjë rastin e Albtelecom dhe as mund të gjykohet për një monopol të tillë në treg kur e gjithë panorama e paraqitur prezanton plotësisht të kundërtën e këtij parimi: Ofrimin e këtyre shërbimeve nga më shumë se një operator, cmime mjaft konkurruese dhe mungesë të plotë interesi për përdorimin e infrastrukturës së Albtelecom.

4. Albtelcom shprehet se AKEP pranon faktin se nuk ekzistojnë barriera të larta dhe të pakalueshme të natyrës ligjore, rregullatore, teknologjike apo ekonomike për hyrjen në tregjet me shumicë LLU/Bitstream për operatorët e tjerë. Avancimi i teknologjive, zhvillimi i rrjeteve të operatorëve të tjerë kanë ndikuar në zvogëlimin e përshkallëzuar të mundësive të përfitimit të tyre prej Albtelcom. Ofrues të rinj kanë rritur presionin negociues në treg, cka duket në numrin e operatorëve që operojnë. Si rezultat i presionit në treg është ngushtuar ndjeshëm kërkesa për përdorimin e rrjetit Albtelcom.
5. Albtelcom shprehet se AKEP në marrjen e masave rregullatore është orientuar vetëm ndaj faktorit të madhësisë së pjesës së tregut për të vlerësuar statusin e Albtelcom në këto tregje. Ndërkohë, nga analiza e kriterëve të tjerë si ekzistenca e pengesave të mundshme për të hyrë në treg, ekzistenca e barrerave të natyrës ligjore apo strukturore, apo fuqia kundërvepruese e blerësve rezulton një zbehje e dukshme të fuqisë ndikuese të Albtelcom (*faqe 43 e dok, perfundimtar*).
6. Një tjetër pretendim i Albtelcom lidhet me detyrimin për kontroll të tarifës për shërbimet Bitstream, që i shtohet Albtelcom duke i përcaktuar metodologjinë e tarifimit të këtyre shërbimeve në vendimin final të miratimit të Analizës së Tregut dhe përcaktimit të statusit me FNT për Albtelcom, pa iu nënshtruar paraprakisht procesit të këshillimit publik në lidhje me këtë detyrim. Në pikën 2 te nenit 2 “Metodologjia” të Rregullores së analizës së tregut thuhet se: *”Dokumenti i analizës së tregut përmban përkufizimin e detajuar të tregut përkatës, dimensionin e produktit/shërbimit dhe gjeografik, testin e tre kriterëve sipas pikës 4 të nenit 3 analizën për FNT dhe detyrimet rregullatore për FNT. Specifikimi i detyrimeve të vecanta rregullatore mund të kryhet me akte të tjera të AKEP”*.

Albtelcom shpjegon se AKEP në publikimin e dokumentit për këshillim publik nuk ka përmendur detyrime të tjera ndaj Albtelcom përveç atyre të imponuara nga VKD Nr. 1565, 13.04.2011.

Albtelcom po përballet me këtë detyrim të ri vetëm në momentin që bëhen publike përfundimet e analizës, duke mos i lënë mundësi kohore të bëjë vlerësimet e rastit të efekteve ekonomike dhe financiare apo të bëjë parashikimet e duhura në plan bizneset e tij duke krijuar kështu vështirësi të trajtimit të këtij detyrimi në kohë reale. Vetë dokumenti i këshillimit publik nuk ka përmendur në asnjë rast vendosjen e këtij detyrimi për Albtelcom në mënyrë që t’i mundësohej Albtelcom e drejta për të shprehur opinionin dhe për të bërë vlerësimet e mundshme për efektet ekonomike dhe financiare që derivojnë nga imponimi i metodologjisë së përcaktimit të tarifave.

7. Vendosja e detyrimeve rregullatore, shprehet Albtelcom, në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU) në një kohë kur është investuar me vlera mjaft të konsiderueshme monetare jo vetëm në infrastrukturën e rrjetit të aksesit, por dhe për rritjen e cilësisë dhe të gamës së shërbimeve do të ishte një barrë e rëndë që do t’i dekurajonte këto investime. Këto masa rregullatore nuk do të ndihmonin në promovimin e

konkurrencës dhe për më tepër nuk i shërbejnë qëllimit dhe parimit të sanksionuar që në nenin 1 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar.

Albtelecom shpjegon se, nuk mund të gjykohet nga pozitat kur Albtelecom shihej si I vetmi operator incumbent me shtrirje gjeografike më të madhe në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU), mbi të cilin duhet të vazhdojë të rëndojnë detyrime që aktualisht gjykojmë se nuk justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur.

Sa më lart, Albtelecom i kërkon AKEP-it, të rishikojë dhe rivlerësoje pozicionin e Albtelecom në këtë treg, dhe bazuar në nenin 138, pika 1 dhe nenin 146, të K.Pr.A, kërkon shfuqizimin/ revokimin me efekt të menjëhershëm të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2417, datë 4.2.2014 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” dhe pranimin e këtij ankimi.

Sa më lart AKEP arsyeton, se:

Në tërësinë e tyre, sic edhe shprehet vetë Albtelecom në këtë anikimim, argumentet e trajtuara janë paraqitur edhe në komentet e sjella pas këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut në periudhën përkatës, komente të cilat janë trajtuar nga AKEP në dokumentin final të analizës për të cilat është mbajtur qëndrimi përkatës i cili gjendet në dokumentin përfundimtar të analizës në Ankes 1, i detajuar. Por pavarësisht këtij qëndrimi të mbajtur, në lidhje me pretendimet e paraqitura në këtë ankimim, vihet re një trajtim i përsëritur teorik i pretendimeve, dhe i pambështetur në të dhëna shtesë që provojnë pretendimet përkatëse.

Pretendimi i Albtelecom se tregu i pakicës është në konkurrencë, ndaj si i tillë është i panevojshëm të ndërmerren masa rregullatore që ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të konkurrencës, ka gjetur në qëndrimin e AKEP edhe në komentet e sjella për dokumentin e këshilluar duke mbajtur qëndrimin se: fakti që tregu i pakicës ka tendencë të qartë drejt konkurrencës efektive, kjo në asnjë rast nuk nënkupton se është arritur “stacioni i fundit” i konkurrencës efektive, ndaj është konsideruar e nevojshme për vete rëndësinë që ka zhvillimi i konkurrencës në këto tregje, për të reflektuar rëndësinë e zhvillimit akoma më tej të tregut të aksesit në broadband internet, me qëllim rritjen e nivelit të penetrimit në këtë shërbim, por në këndveshtrimin e kërkesë/ofertës, konkluzioni i AKEP mbi fazën aktuale të zhvillimit të këtij tregu është i drejtë dhe i arsyeshëm. Kjo përbën edhe arsyen përse AKEP ka vlerësuar të drejtë vendosjen e masave rregullatore në tregjet e nivelit të shumicës për aksesin në broadband internet.

Arsyeja kryesore për vijimësinë e masave rregullatore edhe në tregun e bitstream akses në nivelin e shumicës, është dhënia e kohës për nxitje të kërkesave të tregut, dhe kjo nuk përbën ndonjë barrë për Albtelecom, pasi vazhdimësia e masave rregullatore në nivel shumice për një periudhë afatmesme deri në analizën e radhës, justifikon

qëllimin për të cilin vendosen këto masa, për të kuptuar në se realisht tregu nuk ofron asnjë kërkesë të mundshme për këtë shërbim, pasi sic është theksuar edhe në qëndrimin përkatës të mbajtur pas shqyrtimit të komenteve, masat rregullatore të vendosura në analizën pararendëse, nuk kanë qene efektive menjëhere pas vendosjes së tyre, pasi kanë kërkuar kohën e nevojshme për hartimin e tyre, ndaj konsiderohet e nevojshme që në të njëjtat kushte dhe probeleme të identifikuara, me qëllim nxitjen dhe stimulimin e nevojshëm të kërkesave të tregut, faktori kohë është i rëndësishëm.

Ky arsytim i AKEP është në përgjigje të të pretendimeve të Albtelecom për pikat 1-5.

Në lidhje me pretendimet e Albtelecom të paraqitura në pikën 6, AKEP duke vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të këtyre tregjeve, si dhe faktin që mungesa e kërkesave për shërbimet e bitstream akses mund të jetë edhe si rezultat i një tarife të lartë të paarsyeshme të ofruar nga Albtelecom (konstatim nga oferta referencë e bitstream akses e Albtelecom), ka vlerësuar se duhet që tarifat e shërbimeve me shumice të aksesit bitstream në rrjetin Albtelecom të jenë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP, sipas metodës “retail minus”, e bazuar në përvojën ndërkombëtare, dhe është vlerësuar si një mundësi për t'i dhënë shtysë zhvillimit të konkurrencës në këto tregje, dhe nuk përbën ndonjë barrë të rëndë për operatorin, aq më tepër në kushtet kur nuk egziston asnjë kërkesë aktive në këto tregje.

Ndaj kjo masë rregullatore, së bashku me masat e tjera janë konsideruar si mundësi për zhvillimet e mundshme në të ardhmen në këto tregje. Ajo çfarë është më e rëndësishme, për të cilën është shprehur edhe AKEP në VKD-të përkatëse, për vetë natyrën e këtyre tregjeve është vlerësuar se në varësi të ripozicionimit të KE-së për listën e tregjeve si dhe produktet dhe shërbimet si pjesë përbërëse të tyre, atëherë edhe AKEP, bazuar në dinamikën e shërbimeve dhe teknologjive si dhe ndryshimet e propozuara nga KE për rishikimin e listës së tregjeve përkatëse të Rekomandimit të vitit 2007, sidomos për shërbimet e linjave me qira, AKEP gjykon që përfundimet e këtij dokumenti dhe masave rregulluese për FNT do të duhet të jenë objekt rishikimi sipas ndryshimeve të rekomanduara nga KE për tregjet përkatës.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A,

## **V E N D O S:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2417, datë 04.02.2014 për “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” dhe rrëzimin e ankimit.

2. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**  
**PIRO XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE